



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:195517

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06214085

**Ac.nr.4322/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci - kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Nora Bllaca Dula, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.M., nga Lipjani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti diskriminimi dhe kompensimi i pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 489.67 €, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.7143/2021, të datës 26.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 25.09.2024 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditësit V.M., nga Lipjani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7143/2021, i datës 26.01.2022, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr. 7143/2021, të datës 26.01.2022, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit V.M. nga Lipjani, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet diskriminimi ndaj paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, të ia paguaj një pagë mujore neto në shumë të përgjithshme prej 489.67€, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, e PABAZUAR; II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimin të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar C.nr.7143/2021, të datës 26.01.2022, ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim ose ta ndryshoj aktgjykimin duke e

aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Po ashtu, përmes anesës ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës, si dhe shpenzimet e përpilimi të ankesës në vlerë 208 euro dhe taksën gjyqësore për ankesë 31 euro.

Pala e paditur nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 24.08.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt vërtetimi i diskriminimit dhe kompensimi i shpërblimit jubilar, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën në vlerë 489.67 €, me kamatë ligjore 8% nga data e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, si dhe ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës (me decidivisht për arsyet si në padi). E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar e njëjta nuk ka bazë ligjore pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka qenë në fuqi deri me 31.12.2017 dhe duke pretenduar se kërkesa e paditësit është e parashkruar, ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.7143/2021, të datës 26.01.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimi të atakuar gjykata ka theksuar se përmes provave të administruara ka vërtetuar faktin që paditësi marrëdhënien punës tek e paditura e ka themeluar nga data 01.10.2008, ndërsa 10 vite përvojë pune tek e paditura i ka arritur me datën 01.10.2018. Në anën tjetër gjykata ka theksuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, duke iu referuar nenit 90 të Ligjit të Punës, ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2017, andaj ka konstatuar se paditësi ka arritur 10 vite përvojë punë pas skadimit të vlefshmërisë së MPKK-së, duke vendosur kështu si në dispozitivin e aktgjykimi të atakuar. Gjykata ka shtuar se në kohën kur paditësi ka arritur 10 vite përvojë nuk ka qenë asnjë marrëveshje tjetër në fuqi e cila ka njohur të drejtën për shpërblim jubilar. Sa i përket kërkesës së paditësit për vërtetimin e diskriminimit, gjykata ka vlerësuar se meqë kërkesa për shpërblim jubilar nuk ka bazë juridike, rrjedhimisht edhe kërkesa për vërtetimin e diskriminimit është e pathemeltë. Tutje, gjykata ka arsyetuar së në kuptim të nenit 399 të LPK-së ka vendosur pa caktuar seancë gjyqësore, sepse kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e pa themeltë. Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitivin e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) i LPK-së për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi i atakuar është hartuar konform kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 160 të LPK-së, sepse nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykitimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykitimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykitimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me vërtetimin e diskriminimi dhe kompensimin e shpërblimit jubilar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit janë të pabazuara edhe pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që përmes vërtetimi të lëshuar nga Qendra e Paraburgimit – Prishtinë, i datës 08.01.2021, është vërtetuar se paditësi si Zyrtar Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë punon nga data 01.10.2008, me kontratë për periudhë të pacaktuar kohore. Nisur nga kjo, është i saktë konstatimin i gjykatës së shkallës së parë se paditësi 10 vite përvojë të punë i ka arritur me datën 01.10.2018. Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe në mënyrë të plotë.

Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale, pasi që paditësi 10 vite përvojë pune i ka arritur me datën 01.10.2018, dhe nga kjo rezulton se të njëjtit nuk i ka takuar shpërblimi jubilar sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (këtu e tutje MPKK), e cila ka qenë e vlefshme nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2017, dhe kjo referuar edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme GJ.A.nr.40/2023, të datës 27.02.2023, lidhur me vlefshmërinë e Marrëveshjes së Përgjithshme dhe Kontratave Kolektive. Andaj, duke qenë se paditësi 10 vite përvojë pune i ka arritur pas skadimit të vlefshmërisë së MPKK-së, dhe në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi ndonjë marrëveshje apo kontratë tjetër me të cilën paditësit do të ishte njohur e drejta në shpërblim jubilar, Gjykata e Apelit, vlerëson së gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me pathemelësinë e kërkesës për vërtetimin e diskriminimit, duke qenë se paditësi nuk ka pasur vit jubilar gjatë kohës sa MPKK ka qenë në fuqi. Prandaj, duke qenë se pretendimet e të paditurës

në këtë drejtim janë të pa bazuara, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës është marrë në pajtim nenin 450 të LPK-së, meqenëse kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.4322/2022, datë 25.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci